

PRETENDIMET E
SERBISË MBI 'INVESTIMET'
NË KOSOVË NGA NDËRMARRJET
SHOQËRORE SERBE PAS VITIT 1999
NË KONTEKSTIN E
'FINALES SË MADHE' EVENTUALE





Sheshi Nënë Terezë, Hyrja. I · 59A · Nr. 10
Prishtinë, 10000
Republika e Kosovës
T/F: +383 38 746 206
E-mail: ridea.institute@gmail.com
Website: www.ridea-ks.org

STUDIM

MBI

PRETENDIMET E SERBISË MBI 'INVESTIMET' NË KOSOVË NGA NDËRMARRJET SHOQËRORE SERBE PAS VITIT 1999 NË KONTEKSTIN E 'FINALES SË MADHE' EVENTUALE

Tetor 2019

STUDIM
MBI
PRETENDIMET E SERBISË MBI 'INVESTIMET' NË
KOSOVË NGA NDËRMARRJET SHOQËRORE SERBE
PAS VITIT 1999 NË KONTESKTIN E 'FINALES SË
MADHE' EVENTUALE

Ky studim u mbështet nga:



Norwegian Embassy

Deklaratë mohimi: Pikëpamjet dhe analiza në këtë raport janë vetëm të RIDEA-s dhe nuk pasqyrojnë pikëpamjet e donatorit.

Autor: Instituti Kërkimor për Çështje Evropiane dhe të Zhvillimit (RIDEA)

Tetor 2019

Përmbajtja

Shkurtesat.....	i
Hyrje.....	1
Historiku: Ndërmarrjet Shoqërore, të drejtat pronësore dhe privatizimi.....	2
Invistimet në Kosovë nga Ndërmarrjet Shoqërore serbe: Rasti i Brezovicës.....	7
Statusi i minierave të Trepçës dhe kërkesat kreditore	11
KEK, PTK dhe NSH-të tjera dhe kërkesat kreditore.....	13
Prona dhe asetet e ndërmarrjeve shoqërore serbe në Kosovë dhe të ndërmarrjeve shoqërore kosovare në Serbi.....	14
Përfundimet	16
Rekomandimet.....	20

Shkurtesat

AKM	Agjencioni Kosovar i Mirëbesimit
AKP	Agjencioni Kosovar i Privatizimit
KEK	Korporata Energjetike e Kosovës
NATO	Organizata e Traktatit të Atlantikut Verior
NP	Ndërmarrje Publike
NSH	Ndërmarrje Shoqërore
PTK	Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës
RSFJ	Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë
UNMIK	Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë

Hyrje

1. Kosova shpalli pavarësinë nga Serbia në vitin 2008 bazuar në Propozimin Gjithëpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës propozuar nga emisari special i Kombeve të Bashkuara, Marti Ahtisaari. Plani i Ahtisarit propozoi pavarësinë për Kosovën në një periudhë mbikëqyrjeje dhe garanci të caktuara për të drejtat e pakicave. Plani i Ahtisaarit përcaktoi që ndërmarrjet publike (NP-të) të vendosura në Kosovë do t'i transferoheshin Kosovës. Më tutje, Plani i Ahtisaarit përcaktoi që ndërmarrjet shoqërore (NSH-të) do të administrohen nga institucioni pasardhës i Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit. Përkundër kësaj, një numër çështjesh mbeten të hapura në raport me Serbinë në lidhje me të drejtat pronësore të ndërmarrjeve në pronësi shoqërore të vendosura ose me seli në një vend e me asete në tjetrin.
2. Çështje më të ndjeshme janë pretendimet e Serbisë lidhur me asetet strategjike të Kosovës, siç janë Qendra e Skijimit në Brezovicë, Kompleksi i Minierave Trepça (Trepça), Korporata Energjetike e Kosovës (KEK), Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës (PTK) dhe asetet e ndërmarrjeve shoqërore Serbe të cilat gjenden në Kosovë. Sipas rregullave të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare zakonore, resurset natyrore të Kosovës, siç janë minierat dhe rezervat minerare, burimet ujore, malet e kështu me radhë, janë dhe i takojnë Kosovës dhe popullit të saj dhe është e drejta sovrane e Kosovës për t'i shfrytëzuar dhe eksploatuar këto burime. Pretendimet e Serbisë janë dy llojesh: një, që këto pasuri strategjike përbëjnë prona shtetërore serbe, nën supozimin se Kosova është pjesë e Serbisë dhe dy, se këto pasuri janë pronë e kompanive të inkorporuara në Serbi dhe se këto të fundit kanë bërë investime të konsiderueshme në ndërmarrjet shoqërore në krijimin e aseteve nën menaxhimin e tyre.
3. Si rrjedhojë, ky punim do të analizojë çështjen e ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve shoqërore në dritën e pretendimeve të bëra më lartë dhe do të argumentojë se investimet e bëra gjatë ekzistencës së Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë dhe ato të bëra para vitit 1999 i përkasin vendeve

përkatëse ku ndodhen asetet dhe kompanitë përkatëse; së dyti, të gjitha pronat shtetërore të Serbisë si shtet pasardhës i RSFJ-së, duke përfshirë asetet e ndërmarrjeve publike të cilat ndodhen në Kosovë, i kalojnë Kosovës si një shtet suksesor; së treti, ndërmarrjet në pronësi shoqërore që kanë selinë në një shtet por kanë pasuri në një shtet tjetër, duhet të shkëmbehen në baza të barabarta ose të kompensohen nga shtetet përkatëse; dhe së fundi, ky studim propozon mekanizma për zgjidhjen e pretendimeve të bëra nga palët negociuese si dhe pretendimet e kreditorëve mbi ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shoqërore në Kosovë.

Historiku: Ndërmarrjet Shoqërore, të drejtat pronësore dhe privatizimi

4. Republika Socialiste Federative e Jugosllavisë (RSFJ) kishte një ekonomi socialiste të bazuar në ndërmarrje shoqërore dhe iniciativë private shumë të kufizuar. Si rezultat, në RSFJ kishte tri kategori të pronave, në krahasim me dy kategori që shiheshin në vende tjera në Evropë dhe vende të tjera jo-socialiste. Kishte pronë publike ose shtetërore; pronë private; dhe një kategori të tretë të pronës shoqërore, e cila ishte pronë e të gjithë shoqërisë që ishte vënë nën përdorimin dhe administrimin e ndërmarrjeve shoqërore për të gjeneruar prodhim ekonomik, punësim dhe arritjen e idealeve socialiste të barazisë dhe pronësisë mbi mjetet e prodhimit. Ndërmarrjet shoqërore kanë fituar të drejta pronësore kryesisht pas Luftës së Dytë Botërore dhe në veçanti pas miratimit të Kushtetutës së RSFJ-së të vitit 1974. Prona shoqërore u krijua nga shtetëzimi dhe transformimi i pronës private të konfiskuar apo shtetëzuar nga RSFJ dhe nga shtetëzimi dhe transformimi i tokës bujqësore. RSFJ-ja konfiskoi dhe shtetëzoi pronën private të atyre që konsideroheshin "armik i shtetit" ose "kolaboracionistë" të lëvizjeve kundër socializmit, siç janë liberalët dhe aktivistët

anti-komunistë.¹ Toka bujqësore u shtetëzua dhe u shndërrua në pronë shoqërore bazuar në ligje të cilat vendosnin kufizime mbi sasinë e tokës që qytetarët mund të posedonin.²

5. Ndërmarrjet shoqërore nuk zotëronin prona në kuptimin tradicional, pra të njëjtat nuk kishin titull si pronar mbi pronën nën përdorimin dhe administrimin e tyre. Përkundrazi, ato kishin vetëm të drejtë të përdornin pronën nën menaxhimin e tyre për qëllime ekonomike të ndërmarrjeve. Kështu, prona nën posedim dhe administrim të ndërmarrjeve shoqërore konsiderohej si pronë e të gjithë shoqërisë në të cilën ndodheshin.³ Kjo ndryshoi në vitin 1989 me miratimin e të ashtuquajturave *ligje të Markoviqit* nga Serbia, i cili paraqiti një sistem diskriminues të privatizimit, transformimit dhe transferimit të të drejtave pronësore të ndërmarrjeve shoqërore dhe asetëve të tyre në Kosovë shtetasve serbë, ndërmarrjeve të inkorporuara në Serbi si dhe, shtetasve të huaj dhe personave të huaj juridik.⁴ Si rezultat, ndërmarrjet shoqërore strategjike dhe pasuritë nën administrimin e tyre janë transformuar, nga ndërmarrje shoqërore të vendosura në Kosovë dhe nën pronësi të shoqërisë kosovare dhe komunave të saj, në pasuri të ndërmarrjeve shoqërore ose shoqërive aksionare me seli në Serbi dhe nën pronësinë e shtetit Serb.

6. Kosova ishte pjesë e RSFJ-së si një krahinë autonome së bashku me Vojvodinën. Ajo gëzonte të drejta të zgjeruara politike dhe ekonomike, deri në vitin 1989, kur autonomia e saj u revokua nga regjimi i Sllobodan Millosheviqit dhe e njëjta u shndërrua si pjesë e Serbisë. Kosova ishte një nga rajonet më pak të zhvilluara të RSFJ-së krahasuar me republikat e tjera që gëzonin investime më të mëdha dhe ekonomi më të fortë. Me qëllim të adresimit të pabarazisë brenda anëtarëve të saj, RSFJ krijoi të ashtuquajturin *Fond për Kreditimin e Zhvillimit të Republikave*

¹ Instituti Kosovar Për Kërkime dhe Zhvillime të Politikave (2005), 'Misioni i Kombeve të Bashkuara në Kosovë dhe Privatizimi i Pronës Shoqërore: Përshkrim kritik i procesit aktual të Privatizimit në Kosovë.' Në dispozicion në:

http://www.kipred.org/repository/docs/Misioni_i_Kombeve_t%C3%AB_Bashkuara_n%C3%AB_Kosov%C3%AB_dhe_Privatizimi_i_Pron%C3%ABs_Shoq%C3%ABrore_8282.pdf [Qasur më 25 shtator 2019].

²Po aty.

³ Knudsen, R. (2010), 'Privatizimi në Kosovë: Projekti Ndërkombëtar 1999-2008, fq.76.' Në dispozicion në: <https://www.files.ethz.ch/isn/121346/Knudsen%20report-NUPI%20Report.pdf> [Qasur më 25 shtator 2019].

⁴Po aty, fq.32.

dhe Krahinave Autonome më Pak të Zhvilluara, i cili ofronte fonde për zhvillimin e republikave më pak të zhvilluara krahasuar me republikat tjera të RSFJ-së, sikurse ishte Maqedonia, dhe krahinat autonome, siç ishte Kosova. Nga investimet e bëra nga ky fond si dhe nga shfrytëzimi i burimeve natyrore të Kosovës, Kosova zhvilloi ekonominë e saj, bazuar kryesisht në asetet strategjike dhe industriale sikurse Trepça, minierat e thëngjillit dhe linjtit, turizmi dhe bujqësia.

7. Përfundimisht, RSFJ u shpërbë - pushoi së ekzistuari si shtet - pas kolapsimit të ekonomisë dhe luftës ndërmjet ish-republikave të RSFJ-së. Serbia humbi kontrollin mbi Kosovën në vitin 1999, pas një fushate të vrasjeve masive, spastrimit etnik dhe shkatërrimit të pronës nën udhëheqjen e Millosheviqit që më pas shkaktoi ndërhyrjen humanitare të NATO-s dhe të shteteve aleate. Tërheqja e forcave serbe nga Kosova dhe hyrja e trupave të NATO-s si dhe instalimi i administratës së Kombeve të Bashkuara në Kosovë (UNMIK) nën Rezolutën e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara 1244, shënoi fundin e konfliktit të Kosovës dhe aktin e fundit të shpërbërjes së RSFJ-së.
8. Pas vitit 1999, ndërmarrjet shoqërore si dhe pronat shoqërore, janë vënë nën administrimin e UNMIK-ut bazuar në Rregulloren e UNMIK-ut Nr. 1999/1 të 25 qershorit 1999, e cila ndër të tjera parashihte që UNMIK-u ka mandat për të administruar me pasurinë e luajtshme dhe të paluajtshme në territorin e Kosovës në rast se ekziston bazë e arsyeshme për të konkluduar se këto prona janë të regjistruara në emër të RSFJ-së ose Republikës së Serbisë, ose ato prona janë prona shoqërore. UNMIK-u filloi me procesin e privatizimit të ndërmarrjeve shoqërore dhe asetëve të tyre përmes Agjencisë Kosovare të Mirëbesimit (AKM), e cila po administronte me ndërmarrjet shoqërore dhe asetet e tyre. Procesi i privatizimit synonte krijimin e një ekonomie të tregut të lirë në Kosovë duke privatizuar ndërmarrjet shoqërore dhe asetet e tyre. Paratë e krijuara përmes procesit të privatizimit u vendosën nën kujdestari të AKM-së dhe më vonë institucionit pasues të saj - Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP). Këto para do të përdoren më vonë për të paguar pretendimet e kreditorëve ndaj ndërmarrjeve shoqërore; një përqindje do të shkojë drejt ish-punonjësve si bartës të interesit

dhe çdo fitim i mbetur do t'i kthehet shoqërisë kosovare dhe ekonomisë së saj përmes buxhetit të Kosovës.

9. Procesi i privatizimit i zbatuar në Kosovë nga AKM-ja e UNMIK-ut dhe më vonë nga AKP-ja e Kosovës nuk ka marrë një qëndrim të qartë mbi çështjen e privatizimit, transformimeve dhe të drejtave të kreditorëve të krijuara në periudhën midis viteve 1989 dhe 1999 mbi ndërmarrjet shoqërore dhe asetet e tyre në Kosovë. Procesi i privatizimit nuk e mohon faktin se ndërmarrje të caktuara shoqërore mund të kenë kreditorë legjitimë që kanë investuar në këto ndërmarrje gjatë periudhës 1989-1999, kështu që pretendimet e këtyre kreditorëve duhet të adresohen së pari nga të ardhurat e privatizimit të ndërmarrjeve përkatëse shoqërore.

10. Kosova shpalli pavarësinë e saj nga Serbia në shkurt të vitit 2008, duke u njohur deri më tani nga më shumë se 116 shtete sovraane. Përderisa Kosova ka shpallur pavarësinë e saj nga Serbia dhe pa pëlqimin e Serbisë, ajo nuk ka kaluar nëpër një proces të trashëgimisë së shteteve apo sukcesionit, ku të gjitha çështjet, si trashëgimia mbi traktatet, borxhet dhe detyrimet, arkivat dhe kështu me radhë do të ishin pajtuar reciprokisht përmes një marrëveshjeje të dyanshme ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Megjithatë, Kosova shpalli pavarësinë e saj bazuar në Planin e Ahtisarit, i cili propozoi pavarësi për Kosovën me një periudhë të mbikëqyrjes ndërkombëtare dhe garanci të zgjeruara për mbrojtjen e të drejtave të pakicave kombëtare.

11. Sa i përket pronës, ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve shoqërore, Plani i Ahtisarit parasheh që ndërmarrjet publike në Kosovë do t'i transferohen Kosovës dhe komunave të saj, ndërsa ndërmarrjet shoqërore duhet të privatizohen nga institucioni pasues i AKM-së.⁵ Deri më tani, shumica e ndërmarrjeve shoqërore dhe asetet e tyre janë privatizuar ose likuiduar. Megjithatë, disa ndërmarrje në pronësi shoqërore, e të cilat konsiderohen si gjigantë të ekonomisë së Kosovës, nuk janë privatizuar ende ose asetet e tyre

⁵Kuvendi i Kosovës (2007), 'Plani Gjithpërfshirës për Zgjidhjen e Statusit të Kosovës'. Në dispozicion në: <https://www.kuvendikosoves.org/common/docs/Comprehensive%20Proposal%20.pdf> [Qasur më 25 shator 2019].

nuk janë likuiduar. Dy nga gjigantët e tillë janë Kompleksi Minierave Trepça dhe Qendra e Skijimit Brezovica. Aktualisht, Kompleksi i Minierave Trepça, i cili ndodhet ndërmjet Mitrovicës në pjesën jugore dhe pjesës veriore të Kosovës dhe menaxhohet nga dy trupa menaxhuese, një trup menaxhues shqiptar i Kosovës e dhe një menaxhment serb i Kosovës, ku të dy menaxhmentet pretendojnë se janë menaxherë legjitimë dhe komunitetet e tyre përkatëse janë pronarë të Trepçës. Në tetor 2016, Kuvendi i Kosovës miratoi Ligjin Nr. 05/ L-120 mbi Trepçën, i cili parasheh që Qeveria e Kosovës është pronare e 80% të aksioneve të Minierave të Trepçës, ndërsa punonjësit janë pronarë të 20% të aksioneve. Nga ana tjetër, Qendra e Skijimit në Brezovicë, e cila gjendet në komunën e Shtërpçës, një komunë me shumicë serbe, është pjesërisht operative, pa investime të mëdha të bëra pas vitit 1999. Meqenëse Serbia pretendon se Kosova është pjesë e saj, gjithashtu pretendon se këto ndërmarrje shoqërore janë gjithashtu pronë e saj.

12. Më 3 shtator 2014, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Vendimin Preliminar Nr. 06/195 me të cilin miratoi shtetëzimin e tokës dhe objekteve të caktuara të cilat bijnë në territorin në të cilin ishte planifikuar zhvillimi i Qendrës së re Turistike të Brezovicës. Vendimi Preliminar u bëri thirrje pronarëve të tokës dhe objekteve të paraqesin çdo ankesë të mundshme që mund të kenë kundër shtetëzimit. Më 23 shtator 2015, Qeveria e Kosovës ka nxjerrë Vendimin Përfundimtar Nr. 10/50, me të cilin shtetëzoi tokën dhe objektet për arsye të interesit publik për zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës. Përsëri, Vendimi Përfundimtar parashihte se të gjitha palët e interesuara mund të paraqesin ankesë kundër vendimit brenda tridhjetë ditëve nga njoftimi i tyre me vendimin. Asnjë ankesë nuk është paraqitur nga ndonjë person juridik që pretendon pronësinë mbi Qendrën Turistike të Brezovicës gjatë kësaj periudhe. Në vend të kësaj, më 22 janar 2016, një ndërmarrje e quajtur Shoqëria Holding Fond Inex Interexport A.D., paraqiti një Ankesë në Gjykatën Kushtetuese të Kosovës kundër Vendimit Përfundimtar Nr. 10/50, duke pretenduar se vendimi shkelë të drejtat ligjore dhe pronësore të saj, si dhe e diskriminon këtë ndërmarrje në bazë të përkatësisë etnike të saj. Më 12 prill 2016, Gjykata Kushtetuese e Kosovës mori Aktvendimin mbi Papranueshmëri për Rastin Nr. KI17/16 në lidhje me këtë ankesë. Aktvendimi thekson se Ankesa është e

papranueshme sepse Paditësi nuk i kishte shteruar të gjitha mjetet juridike në dispozicion para se të paraqiste Ankesën në Gjykatën Kushtetuese. Si i tillë, Vendimi Përfundimtar Nr. 10/50 i Qeverisë së Kosovës është ende në fuqi dhe po bëhen përpjekje për zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës. Qeveria e Serbisë në anën tjetër kundërshton vazhdimisht këtë zhvillim, duke pretenduar se ka bërë investime të konsiderueshme në Brezovicë dhe se duhet të arrihet një marrëveshje me pronarët e ligjshëm të tokave, ndërtesave, teleferikëve dhe aseteve tjera në Brezovicë.

Invistimet në Kosovë nga Ndërmarrjet Shoqërore serbe: Rasti i Brezovicës

13. Qendra e Skijimit në Brezovicë, e cila shtrihet në Parkun Kombëtar të Sharrit në kufi me Maqedoninë, u zhvillua gjatë ekzistencës së RSFJ-së, me investime të mëdha që ndodhën në fund të viteve 1970, në pritje të shërbimit për disa nga ngjarjet e skijimit të Olimpiadës Dimërore të Sarajevës të vitit 1984. Gjatë kësaj periudhe janë ndërtuar teleferikët, hotelet dhe objekte tjera. Asnjë investim i madh nuk ka ndodhur më pas, kështu që kjo qendër e turizmit dimëror u degradua vazhdimisht. Qendra e Skijimit në Brezovicë ka qenë në operim dhe është menaxhuar nga Fondi Inex Interexport A.D. (Inex), i cili tashmë ishte i njohur si Inex Interexport dhe Inex Tourism. Inex ishte një ndërmarrje shoqërore me seli në Beograd, i cili shërbeu si kryeqytet i RSFJ-së gjatë ekzistencës së saj. Inex është tërhequr nga procesi i privatizimit në Serbi, për shkak të pretendimeve pronësore që ajo ka në territorin e Kosovës. Më 5 nëntor 2015, që përkon me datën e Vendimit Përfundimtar të Qeverisë së Kosovës Nr. 10/50, Qeveria e Serbisë miratoi Vendimin 05 Nr. 023-11332 / 2015 përmes së cilit është shndërruar në pronare të ndërmarrjes shoqërore Inex.⁶ Në këtë mënyrë, Inex u shndërrua në një kompani publike të Republikës së Serbisë.

14. Më 20 maj 2008, Inex si shoqëri amë e themeloi kompaninë "Ski Center Brezovica doo", me seli në Beograd, Serbi. Aksionarë të kompanisë "Ski Center

⁶Shënime në Raportin Financiar të Inex për vitin 2017.

Brezovica doo" janë Inex me 78.27% të aksioneve dhe shoqëria Ski Resorts of Serbia me 21.73% të aksioneve. "Ski Center Brezovica doo" u regjistrua me një kapital aksionar prej 18,870,322.74 Euro, i përbërë nga 360,202.74 Euro të kontributeve monetare dhe 18,510,120 Euro të aseteve të luajtshme dhe të paluajtshme të transferuara në kompaninë e sapokrijuar.⁷ Pas vitit 2008, aksionerët e "Ski Center Brezovica doo" e kanë rritur kapitalin disa herë, më së fundi në vitin 2016, duke raportuar një kapital të përgjithshëm prej 1,677,386,879.57 dinarë serbë, ose 14,106,823.65 Euro bazuar në kursin e këmbimit të datës 30 dhjetor 2017 prej 0.00841 RSD/EUR. Bazuar në kursin aktual të këmbimit prej 0.00844 RSD/EUR, kapitali aksionar i "Ski Center Brezovica doo" është në vlerë 14,157,145.26 Euro. Prej këtij kapitali, "Ski Center Brezovica doo" raporton që nga data 31 dhjetor 2017 që zotëron tokë, objekte (ndërtesa), pajisje dhe objekte në ndërtim e sipër me vlerë rreth 1,225,497,000 dinarë serbë, ose 10,306,429.77 Euro bazuar në kursin e këmbimit të datës 30 dhjetor 2017 prej 0.00841 RSD/EUR.

15. Pas shpalljes nga Qeveria e Kosovës se ka nënshkruar një marrëveshje për zhvillimin e Qendrës Turistike të Brezovicës pas miratimit të Vendimit Përfundimtar 10/50, Qeveria e Serbisë ka lëshuar disa deklarata duke pretenduar se ka investuar në Brezovicë dhe është pronar i ligjshëm i kësaj qendre. Nëse ky pretendim është i vërtetë, vlera e këtyre investimeve si dhe vlera e përgjithshme e aseteve të Inex-it në Brezovicë duhet të vlerësohen në shumën prej 1,677,386,879.57 dinarë serbë ose ekuivalentin e kësaj shume në Euro, të cilat Qeveria e Kosovës eventualisht do të mund t'ia kompensojë Inex-it ose Republikës së Serbisë si rezultat i Vendimit Përfundimtar Nr. 10/50 të datës 23 shtator 2015.

16. Nëse pretendimet pronësore të Inex-it dhe Serbisë mbi Qendrën e Skijimit në Brezovicë janë të vërteta, atëherë shuma e lartpërmendur duhet të përbëjë vlerën e vërtetë dhe aktuale të këtyre aseteve sikurse janë raportuar nga vetë "Ski Center Brezovica doo" dhe kështu eventualisht do të mund të kompensohej nga Kosova si rezultat i shtetëzimit të pronës nën administrimin e Inex-it.

⁷Shënime në Raportin Financiar të Ski Center Brezovica për vitin 2017.

17. Inex, "Ski Center Brezovica doo" ose Serbia duhet të dëshmojnë megjithatë se ata kanë investuar me të vërtetë shumën e cekur më lartë pas vitit 1999, pasi që çdo investim i bërë gjatë ekzistimit të RSFJ-së ose para vitit 1999 janë bërë nga Inex si ndërmarrje shoqërore, e cila ishte një pronë e të gjithë shoqërisë së RSFJ-së, pra edhe e shoqërisë kosovare.
18. Poqëse marrim parasysh të drejtën zakonore ndërkombëtare të aplikueshme me rastin e trashëgimisë së shteteve, Serbia ose Inex, nuk do të kishin pretendime pronësore mbi Brezovicën. Neni 17(1) (a) i Konventës së Vjenës mbi Trashëgiminë e Shteteve në lidhje me Pronën Shtetërore, Arkivat dhe Borxhet të 8 Prillit 1983 (VCSS 1983), parashikon që "prona e paluajtshme shtetërore e Shtetit paraardhës që ndodhet në territorin që lidhet me shtetin pasardhës, do të kalojë në shtetin pasardhës". Në kontekstin e sukcesionit të shtetit, Serbia do të ishte shteti paraardhës, ndërsa Kosova do të ishte shteti pasardhës/sukcesor. Megjithëse VCSS 1983 ende nuk ka hyrë në fuqi, ka rregulla të së drejtës zakonore dhe praktikës shtetërore që mbështesin këtë aspekt të sukcesionit të shtetit në lidhje me pronën e paluajtshme shtetërore. Çështja këtu është nëse Brezovica në përgjithësi, ose asetet e paluajtshme të "Ski Center Brezovica doo" konsiderohen pronë shtetërore e Serbisë.
19. Sikurse u theksua më lartë, Inex, aksionari kryesor i "Ski Center Brezovica doo" ishte një ndërmarrje në pronësi shoqërore, asetet e të cilës shtriheshin në të gjithë RSFJ-në. Inex është shndërruar në kompani publike të Serbisë. Po ashtu, aksionari tjetër, Qendra e Skijimit të Serbisë, është një kompani publike e Serbisë. Nga ana tjetër, çdo pasuri e paluajtshme që këto subjekte pretendojnë se zotërojnë konsiderohet pronë e paluajtshme shtetërore ose pronë publike. Meqenëse Brezovica ndodhet në Kosovë, atëherë rrjedh se këto prona të paluajtshme duhet t'i kalojnë Kosovës si shtet pasardhës, që nga dita e pavarësisë së saj. Një pikëpamje e tillë mbështetet edhe nga praktika shtetërore me rastin e sukcesionit ndërmjet shteteve pasardhëse të RSFJ-së, *përkatësisht* Bosnjës dhe Hercegovinës, Republikës së Kroacisë, Republikës së Sllovenisë, Republikës së Maqedonisë dhe Republikës Federale të Jugosllavisë (Serbia dhe Mali i Zi). Shtojca A - Prona e luajtshme dhe e paluajtshme e Marrëveshjes për

Çështjet e Trashëgimisë të nënshkruar ndërmjet këtyre shteteve, në nenin 2 parasheh që “prona e paluajtshme shtetërore e RSFJ-së e cila është e vendosur në territorin e RSFJ-së do t'i kalojë shtetit suksesor në territorin e së cilit gjendet prona”. Në anën tjetër, Shtojca G – Prona private dhe të Drejtat e Fituara në Marrëveshjen për Çështjet e Trashëgimisë në nenin 1 parasheh që “prona private dhe të drejtat e fituara të qytetarëve dhe personave të tjerë juridik të RSFJ-së mbrohen nga Shtetet pasardhëse...” Më tutje, neni 2 i Shtojcës G parasheh që “të drejtat në pronën e luajtshme dhe të paluajtshme të cilat ndodhen në një shtet suksesor, dhe të cilat i kanë takuar qytetarëve dhe personave juridik të RSFJ-së më 31 dhjetor 1990, do të njihen, mbrohen dhe restituohen nga ai shtet në përputhje me standardet dhe normat e përcaktuara të së drejtës ndërkombëtare dhe pavarësisht nga kombësia, shtetësia, vendqëndrimi ose vendbanimi i atyre personave ...”.

20. Shtojca e mësipërme synon mbrojtjen e të drejtave të pronësisë private të shtetasve dhe personave juridik nga shtetet suksesore të RSFJ-së. Prona e ndërmarrjeve shoqërore si dhe e kompanive publike nuk bie nën kuptimin e "pronës private", por në pronësi publike apo shtetërore. Neni 2 i Shtojcës G vazhdon më tej se “... personat që nuk janë në gjendje të realizojnë këto të drejta do të kenë të drejtën e kompensimit në përputhje me normat ligjore civile dhe ndërkombëtare.” Thënë këtë, edhe nëse toka, ndërtesat dhe pajisjet në Brezovicë duhet të konsiderohen “pronë private” e personave juridik në Serbi, këta persona juridik do të kenë të drejtën e kompensimit të vlerës reale të tregut të atyre aseteve, të cilat sikurse janë deklaruar nga vetë këta persona juridik në Raportin Financiar, kanë një vlerë maksimale prej 14,106,823.65 Euro.

21. Sikurse u pa në pjesën e historikut, ndërmarrjet shoqërore, sikurse Inex gjatë RSFJ-së, nuk kishin pronësi mbi tokën apo pasuritë në kuptimin tradicional, kjo kompani thjeshtë ka pasur në përdorim dhe administrim pasuritë të cilat ndodhen në Brezovicë. Kështu, në rast se Serbia ka transformuar të drejtat pronësore mbi Brezovicën nga e drejta për përdorim në të drejta pronësore të Inex pas vitit 1989 në mënyrë diskriminuese, duke përjashtuar shoqërinë

kosovare, këto të drejta nuk duhet të njihen, kështu që pretendimet e bëra mbi Brezovicën në bazë të pronësisë nuk duhet të njihen poashtu.

Statuasi i minierave të Trepçës dhe kërkesat kreditore

22. Trepça konsiderohet si “gjigant” i ekonomisë së Kosovës, kryesisht për shkak të pasurisë së përceptuar nëntokësore që posedojnë minierat nën menaxhimin e saj. Profesori Michael Palairt shkruan se Trepça u krijua “... në bazë të një kontrate në vitin 1926, përmes të cilës Radomir Pasic, biri i ish-kryeministrit të ish-Jugosllavisë Nicola Pasic, i shiti të drejtat ekskluzive për eksplorimin e mineraleve në Staritrg pranë Mitrovicës në Kosovën e veriut, shoqërisë Selection Trust Ltd. të Londrës. Më 9 shtator 1927, Selection Trust i kaloi këto të drejta shoqërisë Trepça Mines Ltd, nën të cilin emër operonte kompania minerare.”⁸ Pas Luftës së Dytë Botërore, Trepça, si shumica e ndërmarrjeve të tjera në Jugosllavi u shtetëzuan.⁹
23. Pas Luftës së Dytë Botërore deri në vitin 1950, burimet e Trepçës u shfrytëzuan nga RSFJ për eksport në Bashkimin Sovjetik dhe për përdorim në projekte të ndryshme në tërë RSFJ-në.¹⁰ Nga viti 1965 deri në fund të viteve të 70ta dhe në fillim të viteve të 80ta, Trepça përfitoi investime intensive nga RSFJ, e cila sipas disa vlerësimeve arrinë vlerën mbi 4 miliardë dollarë. Megjithatë, këto investime u bënë si pjesë e *Fondit për Kreditimin e Zhvillimit të Republikave dhe Rajoneve Autonome më Pak të Zhvilluara*. Një përqindje e madhe e këtij fondi, rreth 47% është shpenzuar në projekte dhe ndërmarrje në Kosovë, me një vlerë prej më shumë se 4 miliardë dollarë të shpenzuara vetëm në Trepçë. Shumica e këtyre parave u përdorën si subvencione, për të paguar rreth 23,000 punonjës të Trepçës, pavarësisht faktit se Trepça nuk ishte në gjendje të mbështeste vetveten, *përkatesisht* nuk ishte fitimprurëse. Nga këta 23,000 punonjës, vetëm rreth 13,261 ishin të punësuar në fabrikat dhe njësitë e Trepçës në Kosovë, kurse të tjerët ishin të punësuar diku tjetër në republikat e tjera të RSFJ-së. Kur RSFJ

⁸ Palairt, M. (2003), ‘Trepça, 1965-2000, fq.5.’ Në dispozicion në: https://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf [Qasur më 25 shtator 2019].

⁹ Po aty.

¹⁰ Po aty.

ndërpreu “investimet” apo subvencionet ndaj Trepçës në vitet e 80ta, kjo edhe shënoi fundin e periudhës së “artë” të Trepçës.¹¹ Përfundimisht, Trepça kolapsoi dhe u riorganizua gjatë fillimit të viteve të 90ta nga një organizatë e punës së bashkuar në shoqëri aksionare, shumica e aksioneve të së cilës u regjistruan në emër të shtetit Serb. Serbia pretendoi të drejta pronësore mbi asetet e Trepçës bazuar në një skemë të shkëmbimit të borxhit për pronësi në kompani, në bazë të së cilës Serbia shkëmbeu borxhin formal dhe të supozuar që Trepça kishte ndaj Fondit të Zhvillimit të RSFJ-së me të drejta pronësore të shtetit Serb në Trepçë. Në vitin 2001, vlerësohet se Trepça ka pasur borxhe dhe detyrime prej rreth 84.4 milionë euro, nga të cilat rreth 53.2 milionë euro për një kompani greke të quajtur *Mytileneos AS*; 3.86 milionë euro për një entitet francez me emrin *Societe Commercial des Metaux at Minerais (SCMM)*; dhe 4.3 milionë shoqërisë *Jugobanka*, të cilat duhet të zgjidhen nga Trepça ose pasardhësi i saj.

24. Aktualisht, Trepça funksionon si entitet juridik nën administrimin e AKP-së, megjithatë de fakto funksionon si dy subjekte të ndara, një nën menaxhimin e shumicës serbe në veri të Mitrovicës, dhe tjetra nën menaxhimin e shqiptarëve të Kosovës në jug të Mitrovicës.

25. Sipas rregullave dhe parimeve të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, shtetet kanë të drejta sovraane mbi burimet e tyre natyrore. Parimi 21 i Deklaratës së Stokholmit të vitit 1972 thotë se *“Shtetet kanë, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, të drejtën sovraane për të shfrytëzuar burimet e tyre në përputhje me politikën e tyre mjedisore dhe përgjegjësinë për të siguruar që aktivitetet brenda juridiksionit ose kontrollit të tyre nuk shkaktojnë dëmtim të mjedisit të shteteve të tjera ose të zonave përtej kufijve të juridiksionit kombëtar”*.¹² Në mënyrë të ngjashme, Parimi 2 i Deklaratës së Rio të vitit 1992 thekson se *“Shtetet kanë, në përputhje me Kartën e Kombeve të Bashkuara dhe parimet e së drejtës ndërkombëtare, të drejtën*

¹¹Palairt, M. (2003), ‘Trepca, 1965-2000, fq.9.’ Në dispozicion në: https://www.esiweb.org/pdf/esi_document_id_62.pdf [Qasur më 25 shtator 2019].

¹² Programi Mjedisor i Kombeve të Bashkuara (1972), ‘Deklaratë e Konferencës së Kombeve të Bashkuara mbi Mjedisin Njerëzor.’ Në dispozicion në: https://www.ipcc.ch/apps/njilite/srex/njilite_download.php?id=6471 [Qasur më 25 shtator 2019].

sovrane për të shfrytëzuar burimet e tyre në përputhje me politikat e tyre mjedisore dhe zhvillimore, dhe përgjegjësinë për të siguruar që aktivitetet brenda juridiksionit ose kontrollit të tyre të mos shkaktojnë dëmtim të mjedisit të shteteve të tjera ose të zonave përtej kufijve të juridiksionit kombëtar".¹³ Nga kjo rezulton se Kosova ka të drejta sovrane për të shfrytëzuar burimet e veta natyrore, duke përfshirë burimet minerale dhe nëntokësore të saj, burimet ujore, malet dhe resurset e ngjashme.

26. RSFJ-ja ka investuar në Trepçë dhe ka përfituar nga shfrytëzimi i saj. Shumica e këtyre investimeve janë bërë nga Fondi i Zhvillimit të RSFJ-së, të cilat ishin më shumë subvencione pa ndonjë konsideratë sesa kredi që prisnin për tu paguar. Çdo investim i bërë në Trepçë gjatë periudhës deri në vitin 1999 nga Serbia dhe subjektet shtetërore Serbe do t'i kalojnë Kosovës sipas rregullave mbi suksesionin e shteteve, duke përfshirë edhe borxhet e Trepçës.

KEK, PTK dhe NSH-të tjera dhe kërkesat kreditore

27. Bazuar në Planin e Ahtisaarit, të drejtat e pronësisë në ndërmarrjet publike, si KEK-u dhe PTK-ja, duke përfshirë çdo borxh që mund të kenë ndaj kreditorëve ndërkombëtarë, do t'i transferohen Kosovës. Ngjashëm me ndërmarrjet e tjera shoqërore dhe ndërmarrjet publike, KEK dhe PTK janë themeluar gjatë ekzistencës së RSFJ-së. KEK-u menaxhon me rezervat e linjtit të Kosovës, të cilat vlerësohet të jenë ndër më të mëdhatë në botë. PTK ofron shërbime telekomunikuese në Kosovë. Përsëri, pretendimet e Serbisë mbi këto asete dhe burimet natyrore të Kosovës bazohen në supozimin se Kosova është pjesë e Serbisë dhe jo një shtet i pavarur. Ky argument, megjithatë, është i pabazuar, pasi Kosova është shtet sovran, dhe si i tillë ka të drejta sovrane mbi burimet e saj natyrore sikurse është argumentuar më lartë dhe të pronësisë mbi ndërmarrjet publike që ndodhen në Kosovë.

¹³ UNESCO (1992), 'Deklarata e Rios mbi Mjedisin dhe Zhvillimin.' Në dispozicion në: http://www.unesco.org/education/pdf/RIO_E.PDF [Qasur më 25 shator 2019].

28.Gjithashtu, çdo investim i bërë në KEK dhe PTK gjatë periudhës deri në vitin 1999 nga ana e Serbisë dhe subjekteve shtetërore Serbe do t'i kalojë Kosovës sipas rregullave të sukcesionit të shteteve, duke përfshirë çdo borxh të këtyre ndërmarrjeve.

Prona dhe asetet e ndërmarrjeve shoqërore serbe në Kosovë dhe të ndërmarrjeve shoqërore kosovare në Serbi

29.Një çështje tjetër për t'u diskutuar dhe zgjidhur ndërmjet Kosovës dhe Serbisë është statusi i pronave dhe pasurisë së ndërmarrjeve shoqërore të cilat janë të regjistruara dhe me seli në një shtet, por asetet dhe pasuritë e tyre ndodhen në një shtet tjetër. Një opsion, i cili mbështetet gjithashtu nga rregullat e sukcesionit të shteteve, është që këto prona dhe asetet të shkëmbehen, me kusht që ato të përfaqësojnë një shkëmbim të barabartë. Një opsion tjetër do të ishte që të dyja palët të kompensojnë njëra-tjetrën për vlerën e atyre aseteve, të ardhurat e të cilave do të administrohen nga AKP-ja dhe institucioni homolog i saj Serb, ngjashëm me fondet e administruara nga procesi i privatizimit.

30.Në vijim do të shohim se cilat janë këto pasuri dhe cili opsion është më i përshtatshëm dhe më praktik. Meqenëse RSFJ ishte shtet federal, ishte e zakonshme që ndërmarrjet shoqërore me seli në një njësi federale, kishin të drejta pronësore dhe asete në një njësi ose territor tjetër përbërës të RSFJ-së. Siç u theksua më herët, Inex kishte selinë në Beograd, Serbi, ndërsa kishte të drejta pronësore mbi asete në Kosovë, ndër të tjera. AKP ka përpiluar një listë të ndërmarrjeve shoqërore me seli në Serbi, dhe atyre me seli në Kosovë duke precizuar vendndodhjen e aseteve të tyre. Në Kosovë ekzistojnë së paku 46 pasuri apo asete të ndërmarrjeve shoqërore me seli në Serbi.¹⁴ Shumica e këtyre aseteve janë të vendosura në Mitrovicë dhe Prishtinë dhe përbëhen nga dyqane, hapësira të zyrave dhe njësi të prodhimit. Nga ana tjetër, ka të paktën 162 prona të vendosura në Serbi dhe në ish-republikat e tjera të RSFJ-së të ndërmarrjeve shoqërore me seli në Kosovë. Prej këtyre aseteve, 17 ose afro 10% i përkasin Trepçës. Shumica e pronave përbëhen nga dyqane, hapësira të zyrave, toka

¹⁴Përgjigja e Agjencisë Kosovare të Privatizimit në Kërkesën për Qasje në Dokumente Publike.

ndërtimore, depo, ndërtesa, apartamente.¹⁵ 99 asete të ndërmarrjeve kosovare janë të vendosura në Serbi, 34 në Mal të Zi, 14 në Bosnjë dhe Hercegovinë, 6 në Maqedoni, 5 në Kroaci dhe 1 në Slloveni.¹⁶

31. Ndërkohë që statusi dhe të drejtat pronësore që lidhen me pasuritë e ndërmarrjeve shoqërore në Kosovë e të cilat ndodhen në Malin e Zi, Bosnjë e Hercegovinë, Maqedoni të Veriut, Kroaci dhe Slloveni duhet të zgjidhen përmes marrëveshjeve bilaterale në mes të Kosovës dhe këtyre vendeve, një gjë e tillë duhet të bëhet në bazë të parimeve kryesore të së drejtës ndërkombëtare dhe praktikës shtetërore të krijuar me rastin e zgjidhjes së çështjeve të suksesionit të shteteve pas shpërbërjes së RSFJ-së. Parimet e tilla janë njohja reciproke e të drejtave pronësore të qytetarëve privatë dhe të personave juridik të njëri-tjetrit; mbrojtja dhe rivendosja apo restituimi i këtyre të drejtave; mosdiskrimini në çfarëdo baze, dhe në rast të shtetëzimit ose paaftësisë së qytetarëve dhe personave juridikë në ushtrimin e të drejtave të tyre pronësore, kompensimi i drejtë i pronarëve legjitimë.

32. Të njëjtat parime do të respektohen në lidhje me pronën dhe pasuritë e ndërmarrjeve shoqërore kosovare të vendosura në Serbi dhe anasjelltas, *përkatësisht*, njohja reciproke, mbrojtja dhe restituimi i të drejtave pronësore ose kompensimi i drejtë.

33. Sidoqoftë, në rastin e Kosovës dhe Serbisë, meqenëse të dyja shtetet kanë pronë dhe pasuri në njëra-tjetrën, një opion adekuat do të ishte shkëmbimi i pronës dhe pasurisë me kusht që një gjë e tillë të bëhet në baza të barabarta, *pra*, që vlera e aseteve të jetë e ngjashme, nëse jo e njëjtë në të dyja palët. Nëse, megjithatë, shkëmbimi nuk përfaqëson një zgjidhje të barabartë, duhet të përdoret një formë e kombinuar e shkëmbimit dhe kompensimit. Të dyja palët

¹⁵Agjencia Kosovare e Privatizimit. (2017), 'Raport Vjetor 2017 i Agjencisë Kosovare të Privatizimit Për Kuvendin e Republikës së Kosovës.' Në dispozicion në: <http://www.pak-ks.org/desk/inc/media/99BF51A1-E096-4CA0-A606-1EA4C233CDB7.pdf> [Qasur më 25 shtator 2019].

¹⁶Po aty.

mund të përdorin ekspertë të vlerësimit për të përcaktuar vlerën e tregut të aseteve që do të shkëmbehen ose kompensohen.

34. Çdo shkëmbim i pronës ose pasurive ose ndonjë kompensim për këtë qëllim duhet të marrë parasysh të drejtat në kompensim të bartësve të ligjshëm të të drejtave për investimet e bëra pas vitit 1999 minus çdo amortizim të pronës apo zbritjes së vlerës së tregut. Në rast se Serbia dhe Kosova kanë shtetëzuar, privatizuar ose përndryshe kanë mundësuar transferimin e titullit mbi pasuritë e ndërmarrjeve shoqërore të vendosura në territoret e tyre përkatëse, shtetet duhet të kompensojnë njëra-tjetrën ose bartësit e të drejtave me vlerën reale të tregut të atyre pasurive.

Përfundimet

35. Kosova dhe Serbia nuk kanë kaluar nëpër një proces të suksesionit të shteteve, përmes të cilit do të zgjidhnin të gjitha çështjet relevante dhe pretendimet reciproke lidhur me borxhin ndërkombëtar, traktatet, të drejtat pronësore, arkivat, trashëgiminë kulturore dhe çështjet e tjera të trashëgimisë. Negociatat për zgjidhjen e statusit të Kosovës të ndërmjetësuar nga Marti Ahtisari në Vjenë deri në vitin 2006 nuk kanë rezultuar me një zgjidhje të dakorduar nga të dyja palët, me ç'rast çështjet e suksesionit do të zgjidheshin. Për më tepër, procesi i vazhdueshëm i negociatave nën ndërmjetësimin e Bashkimit Evropian është përqendruar kryesisht në çështjet teknike për normalizimin e marrëdhënieve dypalëshe ndërmjet Kosovës dhe Serbisë dhe lehtësimin e lëvizjes së lirë të njerëzve, mallrave dhe shërbimeve, përmes, ndër të tjera, njohjes së dokumenteve dhe targave të makinave, njohjes së dokumenteve doganore. Ky proces aktual negociator, nuk ka adresuar çështjet kryesore të paraqitura në këtë punim për pretendimet mbi të drejtat pronësore mbi burimet natyrore të Kosovës të bëra nga Serbia dhe statusin e të drejtave pronësore dhe kërkesat reciproke të Kosovës dhe Serbisë në lidhje me ndërmarrjet publike dhe ndërmarrjet shoqërore dhe asetet e tyre në shtetet përkatëse.

- 36.** Ky punim ka analizuar çështjen e ndërmarrjeve shoqërore dhe pretendimet për të drejtat pronësore mbi asetet nën menaxhimin e tyre, krijimin e tyre, transformimin e shtetëzimin, privatizimin dhe statusin e tyre ligjor si subjekte shtetërore ose ndërmarrje shoqërore. Më tej, ky punim ka analizuar pretendimet potenciale të kreditorëve mbi borxhet dhe detyrimet e ndërmarrjeve shoqërore të vendosura në Kosovë dhe pretendimet për të drejtat pronësore ndaj pronës dhe aseteve nën menaxhimin e ndërmarrjeve shoqërore në të dy shtetet.
- 37.** Pretendimet kryesore të Serbisë në lidhje me ndërmarrjet shoqërore të Kosovës paraqesin interesim për disa prej aseteve strategjike të Kosovës, siç janë Kompleksi i Minierave të Trepçës, Qendra e Skijimit të Brezovicës, dhe në një masë më të vogël asetet e Korporatës Energjetike të Kosovës dhe asetet e Postës dhe Telekomunikacionit të Kosovës. Serbia kërkon të drejta pronësore mbi këto asete, duke theksuar se ato janë entitete shtetërore. Serbia bënë dy supozime ligjore të pabazuara në lidhje me këtë çështje: e para, që Kosova është pjesë e Serbisë dhe si pasojë burimet natyrore të saj janë pronë e shtetit të Serbisë; dhe së dyti, që personat juridikë në Serbi zotërojnë titull mbi tokën, pronën dhe pasuritë nën menaxhimin e tyre.
- 38.** Kompleksi i Minierave të Trepçës, Korporata Energjetike e Kosovës dhe termocentralet e saj, Posta dhe Telekomunikacioni i Kosovës, Qendra e Skijimit të Brezovicës dhe të gjitha ndërmarrjet e tjera shoqërore në Kosovë u krijuan gjatë RSFJ-së me para që u përkisnin qytetarëve të RSFJ-së, duke përfshirë qytetarët e Kosovës. Burime të tjera të financimit përfshijnë borxhet ndërkombëtare të lidhura nga RSFJ-ja me shtetet tjera ose organizatat ndërkombëtare. Megjithatë, këto borxhe duhet të trajtohen si çështje të borxheve shtetërore në kuadër të procesit të sukcesionit të shtetit. Shumica e ndërmarrjeve shoqërore, përfshirë Trepçën, u financuan ose u subvencionuan nga *Fondi për Kreditimin e Zhvillimit të Republikave dhe Rajoneve Autonome më Pak të Zhvilluara*, si një mekanizëm për të ngushtuar hendekun në zhvillim midis republikave dhe rajoneve të ndryshme të RSFJ-së dhe për të sjell barazi midis të gjithë popujve brenda RSFJ-së. Këto subvencione u shndërruan më vonë në borxhe që ndërmarrjet në pronësi shoqërore i detyroheshin institucioneve

financiare të RSFJ-së. Nga ana tjetër, këto borxhe u përdorën më vonë nga Serbia për të shkëmbyer borxhet për pronësi në ndërmarrjet shoqërore. Prandaj, mbi bazën e kësaj Serbia pretendon pronësinë mbi Trepçën dhe asetet strategjike të Kosovës.

39. Sikurse u vu në pah, Trepça ka kaluar nëpër faza të ndryshme në zhvillimin e saj dhe kishte strukturë të ndryshme pronësie gjatë gjithë ekzistimit të saj. Së pari, ajo u eksplorua dhe u shfrytëzua nga entiteti nga Londra, i quajtur Selection Trust Ltd; më vonë ajo u përdor nga forcat gjermane në Luftën e Dytë Botërore gjatë okupimit të RSFJ-së. Investimet e mëdha ndodhën pas Luftës së Dytë Botërore kur u shtetëzua nga RSFJ. Gjatë kësaj periudhe janë bërë investime të mëdha në Trepçë, ndërsa në anën tjetër burimet e Trepçës janë shfrytëzuar pa mëshirë për të mirën e të gjithë RSFJ-së.

40. Kosova ka të drejtë sovraane për të shfrytëzuar burimet e saj natyrore, duke përfshirë rezervat minerare, burimet ujore në përputhje me rregullat dhe parimet e zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare, të krijuara nga Deklarata e Stokholmit e vitit 1972 dhe Deklarata e Rios e vitit 1992. Çdo borxh dhe të drejtat e kreditorëve privat ndaj Trepçës do të njihen dhe kompensohen në përputhje me rrethanat.

41. Po ashtu, asetet dhe burimet e tjera strategjike nën menaxhimin e ndërmarrjeve publike dhe ndërmarrjeve shoqërore si KEK-u dhe PTK-ja janë pronë e Kosovës, e cila ka të drejtën sovraane për të shfrytëzuar resurset e saj natyrore dhe për të menaxhuar me ndërmarrjet e saj shtetërore.

42. Brezovica ishte nën administrimin dhe menaxhimin e ndërmarrjes shoqërore Inex, me seli në Beograd, Serbi. Inex është transformuar nga një ndërmarrje në pronësi shoqërore në një ndërmarrje publike të Serbisë. Në këtë mënyrë Serbia e konsideron veten si pronare të Qendrës së Skijimit në Brezovicë. Megjithatë, siç është rasti me pronat e tjera publike dhe bazuar në rregullat e trashëgimisë së shteteve, rezulton se Brezovica i ka kaluar Kosovës si shtet suksesor në vitin 2008.

- 43.** Qendra e Skijimit në Brezovicë menaxhohet nga kompania "Ski Center Brezovica doo" me seli në Beograd. "Ski Center Brezovica doo" ka deklaruar në raportin e saj financiar për vitin 2017 se vlera aktuale e asetëve të saj është në shumën prej 1,677,386,879.57 dinarë serbë, ose 14,106,823.65 Euro bazuar në kursin e këmbimit të datës 30 dhjetor 2017 prej 0.00841 RSD/EUR, shumë kjo e cila ndoshta do të duhej kompensuar nga Kosova, si rezultat i shtetëzimit të asetëve në Brezovicë përmes Vendimit Nr. 10/50 të datës 23 shtator 2015.
- 44.** Me shumë gjasë Inex ka përfituar të drejta pronësore mbi asetet në Brezovicë gjatë periudhës pas vitit 1989 në mënyrë diskriminuese, me ç'rast këto të drejta nuk duhet të njihen. Përveç kësaj, Inex nuk kishte të drejta pronësore mbi pasuritë dhe pronën në Brezovicë gjatë RSFJ-së, mirëpo vetëm të drejtë menaxhimi. Çdo transformim në strukturën e pronësisë dhe të drejtat pronësore mbi tokën dhe asetet në Brezovicë, gjatë viteve 1989 deri më 1999, duhet të shqyrtohet hollësisht dhe nuk duhet të merret parasysh poqëse është bërë në mënyrë diskriminuese.
- 45.** Ndërmarrjet shoqërore dhe të drejtat pronësore ndaj asetëve të menaxhuara nga ndërmarrjet shoqërore, janë privatizuar, transformuar ose shkëmbyer në bazë të ligjeve diskriminuese gjatë periudhës 1989-1999 të njohura si *Ligjet e Markoviqit*, të cilat nuk i lejonin shqiptarët të merrnin pjesë ose të konsultoheshin në këtë proces. Si rrjedhojë, këto privatizime ose transformime diskriminuese nuk duhet të merren parasysh poqëse ekziston bazë e mjaftueshme për të konkluduar se janë bërë në mënyrë diskriminuese.
- 46.** Më tutje, ky punim analizoi çështjen e asetëve të ndërmarrjeve shoqërore të vendosura në vendet e tjera dhe opsionet për shkëmbim ose kompensim të të njëjtave. Aktualisht, në Kosovë ekzistojnë së paku 46 asete të ndërmarrjeve shoqërore të Serbisë të cilat janë nën administrimin e AKP-së; ndërsa në Serbi ka të paktën 162 asete të ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës, për të cilat Kosova nuk ka dijeni mbi statusin e tyre brenda Serbisë. Kosova dhe Serbia mund të bien dakord për shkëmbimin e këtyre pasurive në baza të barabarta me njëra-tjetrën,

ose kompensim të tyre. Qytetarët privatë dhe të drejtat e personave juridik privatë do të mbrohen dhe në rast të shtetëzimit, shkëmbimit ose formës tjetër të kompensimit, ata duhet të kompensohen për investimet e bëra.

47. Përfundimisht, nuk ka pasur investime të mëdha në Kosovë dhe në asetet e saj strategjike nga ndërmarrjet shoqërore dhe ndërmarrjet shtetërore me seli në Serbi pas vitit 1999. Të gjitha investimet e pretenduara nga Serbia apo ndërmarrjet Serbe që janë bërë në Kosovë, duhet të vërtetohen me dëshmi.

Rekomandimet

48. Kosova dhe Serbia duhet të bien dakord për një proces të suksesionit së shtetit dhe të nënshkruajnë një marrëveshje të detyrueshme për çështjet e suksesionit së shtetit, të ngjashme me atë të nënshkruar midis republikave ish-përbërëse të RSFJ-së, me ç 'rast do të adresonin çështjet e paraqitura në këtë punim dhe çështje të tjera, të tilla si borxhet, pensionet, trashëgimia kulturore, arkivat dhe çështjet e tjera të trashëgimisë së shteteve.

49. Kompleksi i Minierave i Trepçës dhe rezervat minerare nëntokësore nën menaxhimin e saj janë pronë e Kosovës dhe vetëm Kosova ka të drejtën sovranë për të shfrytëzuar burimet e saj natyrore sipas rregullave të zbatueshme të së drejtës ndërkombëtare. Serbia nuk mund të pretendojë të drejtën e pronësisë për Trepçën dhe asetet e saj, pasi ato janë ndërtuar dhe shfrytëzuar nga RSFJ gjatë ekzistencës së saj. Trepça duhet të njohë borxhet dhe detyrimet e saj ndaj kreditorëve privatë si *Mytileneos AS* dhe SCMM, dhe këto borxhe duhet të paguhën nga Trepça ose Shteti i Kosovës si pronar i Trepçës.

50. Borxhet ndërkombëtare të RSFJ-së të marra për financimin e ndërmarrjeve shoqërore, siç është Trepça dhe Qendra e Skijimit të Brezovicës, do të trajtohen me Serbinë në kontekstin e trashëgimisë së borxheve në baza të barabarta. Serbia nuk mund të pretendojë dhe Kosova nuk duhet të njohë pretendimet e Serbisë si Kreditor i ndërmarrjeve shoqërore, si rezultat i kredive të dhëna për

ndërmarrjet shoqërore nga RSFJ përmes *Fondit për Kreditimin e Zhvillimit të Republikave dhe Rajoneve Autonome më Pak të Zhvilluara*.

51. Trepça ose Republika e Kosovës mund të lidhin marrëveshje me kreditorët e Trepçës për të paguar pretendimet e tyre përmes mjeteve alternative, si përmes produkteve minerale, aksioneve në shoqëri ose formave të tjera të pagesës ose nëpërmjet ristrukturimit të borxhit.
52. Dhoma e Posaçme për Çështjet e Privatizimit të Gjykatave të Kosovës duhet të vendos mbi pretendimet e bëra nga kreditorët privatë ndaj ndërmarrjeve shoqërore të Kosovës, sikurse janë Trepça, Qendra e Skijimit në Brezovicë dhe të ngjashme, dhe këto kërkesa duhet të përmbushen nga të ardhurat e realizuara nga shitjet e këtyre ndërmarrjeve, shitjet e aseteve të tyre ose nga Republika e Kosovës në rast të nacionalizimit.
53. Më tutje, subjektet në Serbi dhe kreditorët e tjerë mund të paraqesin kërkesa për investime kundër Kosovës përpara Qendrës Ndërkombëtare Për Zgjidhjen e Mosmarrëveshjeve të Investimeve të Bankës Botërore në Uashington D.C, në rast se të njëjtit kanë kërkesa legjitime të investimeve kundër Kosovës.
54. Qendra e Skijimit në Brezovicë i ka kaluar Kosovës si pronë publike në ditën e shpalljes së pavarësisë, pasi kompania që pretendon të drejta pronësore mbi Brezovicën është kompani shtetërore e Serbisë. Në anën tjetër, nëse Serbia nuk e pranon këtë pozicion të Kosovës, shuma eventuale maksimale që Inex do të kishte drejtë në kompensim për vlerën e tregut të aseteve në Brezovicë është shuma prej 14,106,823.65 Euro, që përfaqëson kapitalin aksionar dhe vlerën e aseteve në Brezovicë sikurse janë raportuar nga "Ski Center Brezovica doo" në Raportin e saj Financiar për vitin 2017. Por, Inex, "Ski Center Brezovica doo" ose Serbia duhet të dëshmojnë megjithatë se ata kanë investuar me të vërtetë shumën e cekur më lartë pas vitit 1999, pasi që çdo investim i bërë gjatë ekzistimit të RSFJ-së ose para vitit 1999 janë bërë nga Inex si ndërmarrje shoqërore, e cila ishte një pronë e të gjithë shoqërisë së RSFJ-së, pra edhe e shoqërisë kosovare.

- 55.** Pasuritë e ndërmarrjeve shoqërore duhet të njihen, mbrohen dhe kompensohen. Pasi që Kosova dhe Serbia kanë pasuri në njëra-tjetrën, ato mund të bien dakord për shkëmbimin e këtyre aseteve, me kusht që një shkëmbim i tillë të bëhet në baza të barabarta. Nga ana tjetër, Kosova dhe Serbia mund të bien dakord për kompensimin e aseteve, të cilat do të duhej vlerësuar përmes një procesi të vlerësimit profesional. Të drejtat e qytetarëve privat ose të subjekteve private mbi pasuritë, në rast se janë përfituar në mënyrë të drejtë duhet të mbrohen sipas Konventës Evropiane për të Drejtat dhe Liritë e Njeriut ose të kompensohen nga shtetet në rast të transformimit apo shtetëzimit të tyre.
- 56.** Një proces i restituimit të të drejtave pronësore duhet të iniciohet në rast se Serbia insiston në pretendimet mbi pronat në Kosovë. Procesi i restituimit të të drejtave pronësore do t'i mundësonte qytetarëve edhe entiteteve private në Kosovë, pronat e të cilëve u privatizuan, konfiskuan ose transformuan gjatë periudhës ndërmjet 1989 deri në vitin 1999 për të kërkuar njohjen e të drejtave të pronësisë mbi pronat që u transformuan në mënyrë diskriminuese gjatë kësaj periudhe.
- 57.** Të drejtat legjitime të kreditorëve duhet të njihen dhe në masë të mundshme të mbrohen ose të kompensohen nga të ardhurat e krijuara nga procesi i privatizimit ose nga buxheti i Kosovës.
- 58.** Në rast se Kosova dhe Serbia nuk mund të bien dakord mbi çështjet e mësipërme dhe çështje të tjera të ndërlidhura me procesin e sukcesionit të shtetit, ato mund të themelojnë një tribunal arbitrazhi i ngjashëm me Komisionin e Badinterit për RSFJ-në, i cili përfundimisht do të zgjidhte të gjitha çështjet e pazgjidhura.

